



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:074480

Datë: 05.04.2019

Numri i dokumentit: 00269315

P.nr.233/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Berna Maliqi, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh... L... nga fshati L..., për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokatinga Gj..., duke vepruar sipas propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, të paraqitur nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.169/2018, të datës 15.03.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe jo publik, me datë 29.03.2019, mori ndërsa me datë 05.04.2019, përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I pandehuri Sh... L..., nga babai B... dhe nëna M..., e lindur H..., i lindur me datë..., në Gj..., me vendbanim në fshatin L..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar në sektor privat, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse me datë 30.01.2019, gjatë tërë ditës dhe në orët e mbrëmjes deri në ora 23:40 minuta, në fshatin L..., në shtëpinë e përbashkët, i pandehuri në gjendje të paaftësisë mendore të zvogëluar në masën jo esenciale, me qëllim të shkakimit të frikës dhe ndjenjës së pasigurisë, me sjelljen dhe komunikimin e tij të vazhdueshëm e fyen, ofendon, kërcënon dhe ngacmom bashkëjetuesen e tij-të dëmtuarën S... V.... dhe fëmijët e tyre të mitur, ashtu që pasi që gjatë tërë ditës dhe orëve të mbrëmjes pa ndonjë arsye shanë dhe ofendon të dëmtuarën, dhe në prani të fëmijëve të tyre të mitur, pa ndonjë arsye bërtet në mënyrë të përsëritur me ton agresiv duke frikësuar të njejtit, më pas tensionohet tej mase dhe fillon të thyej gota nëpër shtëpi dhe në këtë mënyrë me komunikimin dhe sjelljen e tij të vazhdueshme, ka shkakuar frikë dhe shqetësim të madh emocional tek e dëmtuara dhe fëmijët e tyre të mitur se do të vriten apo do tu shkaktohet lëndim i rëndë trupor të cilën e dëmtuara seriozisht e ka besuar.

Me çka ka kryer veprën penale ngacmimi nga neni 186 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 87,88,89, dhe 90 të KPRK-së, si dhe nenit 514, paragrafi 3 të KPP-ës, i shqipton:

MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUSHËM PSIKIATRIK NË LIRI NË INSTITUCIONIN SHËNDETËSOR

- I. Ndaj të pandehurit Sh... I... shqiptohet masa e trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri, e cila masë do të zbatohet në Qendrën e Shëndetit Mental në Gjilan, duke filluar nga dita kur ky aktvendim të merr formën e prerë dhe e cila masë nuk mund të zgjas më shumë 3 (tre) vjet.
- II. Obligohet i pandehuri Sh.. I..., që pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë, të paraqitet në Qendrën e Shëndetit Mental në Gj..., në mënyrë që t'i nënshtrohet trajtimit psikiatrik, sipas rregullave të caktuara nga mjeku përkatës.
- III. Qendrën e Shëndetit Mental në Gjilan, ËSHTË E OBLIGUAR që së paku 1 (një) herë në 6 (gjashtë) muaj ta njoftojë këtë gjykatë lidhur me gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit të lartpërmendur.
- IV. Në rast se i pandehuri Sh.... I..., nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit të institucionit të kujdesit shëndetësor do ta zëvendësojë këtë masë me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim.
- V. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga shpenzimet publike.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 15.03.2019, pranë kësaj gjykate ka paraqitur propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri me numër PP.II.nr.169/2019, të datës 15.03.2019, të pandehurit Sh... I... nga fshati L....., për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Me datë 29.03.2019, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin të ftuar dhe prezent, prokurori i shtetit, i pandehuri..., mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare,, avokat nga Gj, eksperti i psikiatër Dr..., e dëmtuara..., si dhe dëshmitari B.B..... Para leximit të propozimit nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues ka kërkuar nga eksperti i neuropsikiatrisë Dr... që të konstatohet gjendja aktuale, shëndetësore për të pandehurin për të vlerësuar nëse i njëjti është i aftë për të ndjekur gjykimin me ç'rast eksperti psikiatër ka deklaruar se i pandehuri është i aftë për ta përcjellur gjykimin. Pas leximit të propozimit të lartcekur nga prokurori i shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi propozimin dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë, duke deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në marrë, në bazë të propozimit të paraqitur nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, me ç'rast gjykata me aktvendim procedural pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe atë prokurorit të shtetit, ekspertit të neuropsikistisë ..., mbrojtësit të të pandehurit avokat ...dhe të pandehuritka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale e cila i vihet në marrë në bazë të propozimit të paraqitur nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehurika kryer veprën penale ngacmimi nga neni 186 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, në kohën,vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të masës

Gjykata konform nenit 88, nenit 89 dhe 90 të KPRK-së dhe nenit 514 të KPP-së saktësisht dhe në mënyrë të plotë, vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, ndërsa me rastin e shqiptimit të masës ka marrë parasysh raportin e Institutit të Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë me numër të protokoli..., të datësi datës 30.03.2018, eksperizën e datës 11.02.2019, të bërë nga dr..... dhe mendimin e ekspertit psikiatër dr....., të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku pas dëgjimit dhe mendimit të palëve, në pajtim me nenin 90 paragrafi 1 nën paragrafët : 1.1; 1,2 dhe 1.3 të KPRK-së, konstatoi se për të pandehurin:

- Ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryej prapë vepra të ngjashme penale,
- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për t'iu shmangur kryerjes së veprave penale të tjera, dhe
- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz.

Sipas bindjes së gjykatës kjo masë e shqiptuar ndaj të pandehurit..., duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është masë e drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit dhe se kjo masë do të ndikoj tek i pandehuri në mënyrë që i njëjti të rehabilitohet dhe në të ardhmen të mos përsërisë vepra të tjera penale.

5.Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

E dëmtuara..., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e njëjta nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk paraqet kërkesë pasurore juridike me ç'rast gjyqtari i vetëm gjykues nuk vendosi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Andaj nga arsyet lartcekura, gjykata në pajtim me nenin 514 paragrafi 3 të KPPRK-së lidhur me nenin 90 paragrafi 1 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se do të arrihet qëllimi i rehabilitimit psikiatrik i të pandehurit me paraqitje për trajtim në

institucionin e kujdesit shëndetësor, kështu që i pandehuri do të shmanget nga kryerja e veprave penale të çfarëdo natyre.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.233/2019, më datë 05.04.2019

Procesmbajtësja,
Berna Maliqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij akgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.